



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 nëntor 2021
Nr. ref.:RK 1896/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI99/21

Parashtrues

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës,
Ac.nr.3609/2020, të 13 prillit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Riza Dembogaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Ac.nr.3609/2020] e 13 prillit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
6. Më 24 maj 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 17 qershor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.

10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 3 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 13 janar 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi tek zyra e Përmbaaruesit Privat A. M., propozimin për nxjerrjen e urdhrit përmbaarimor në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr. 204 të 6 qershorit 2013, në të cilën debitori KEDS (Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike) ishte i detyruar që t'ia paguajë parashtruesit-kreditorit shumën 14.216.231,32 euro. Fatura në fjalë ishte lëshuar në pajtim me marrëveshjen e shitjes me shumicë të energjisë elektrike, dhe në pajtim me vendimin e zyrës së Rregullatorit të Energjisë [V-528-2013] të 2 majit 2013, e cila sipas vendimit aplikohet prej 1 prillit 2013, dhe kishte të përcaktuar në baza mujore çmimin për energji dhe tarifën fikse mujore për kapacitet. Parashtruesi i kërkesës, theksonte që përderisa KEDS-debitori, kishte përmbushur pjesërisht obligimin e tij, i njëjti edhe më tej kishte mbetur pa paguar shumën prej 4.340.491,00 euro, nga totali i faturës.
13. Zyra Përmbaarimore e Përmbaaruesit Privat A.M., në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, kishte lëshuar Urdhër [P.nr. 01/16] me të cilin lejoi përmbaarimin në bazë të provës së besueshme-faturës nr. 204 e 6 qershorit 2013, e cila ishte lëshuar në pajtim me Marrëveshjen për Furnizim me shumicë të 17 tetorit 2012, dhe në pajtim me Vendimin e ZRE [V-528-2013] të 2 majit 2013, vlera e faturës për shitjen me shumicë të energjisë elektrike ka qenë gjithsej shuma 14.216.231.32 euro, mirëpo debitori pjesërisht e ka përmbushur borxhin sipas faturës me dt. 12.06.2013 nga data 08-31.05.2013, ndërsa që nuk e kishte përmbushur borxhin nga data 01-07.05.2013, dhe atë në shumë 4.340.491,00 €, nga totali i faturës, me të cilën ka kërkuar që debitori të obligohet t'ia paguaj borxhin parashtruesit të kërkesës në vlerë prej 4.340.491.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga data e lejimit të këtij urdhri deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbaarimit, nën kërcënim të përmbaarimit të dhunshëm.
14. Kundër urdhrit për lejimin e përmbaarimit, brenda afatit ligjor debitori-KEDSI kishte paraqitur prapësim, ku theksonte se dokumenti në bazë të cilit është marrë urdhri përmbaarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbaarueshmërisë ashtu siç e parasheh neni 71 paragrafi 1.1 dhe 1.2 i Ligjit të Procedurës Përmbaarimore (në tekstin në vijim: LPP-së). Debitori më tej theksoi se faturimi ishte në kundërshtim me kushtet e Marrëveshjes të 17 tetorit 2012 për faktin që fatura Nr. 204 përfshinte tërë periudhën e muajit maj nga 1 deri më 31 maj, përderisa Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 8 maj 2013, ndërsa që Fatura 204 është lëshuar në bazë të kësaj marrëveshje. Rrjedhimisht, KEDSI kontestoi vlerën e faturimit për periudhën 1-7 maj 2013 për shumën

4.340.491,09 €, pasi që marrëveshja nuk ka qenë në fuqi dhe në kuptim të nenit 7.3 të Marrëveshjes nuk e ka paguar shumën e kontestuar por ka paguar shumën e pa kontestuar prej 8 deri më 31 maj 2013 në vlerë prej 9,875,740.32 euro.

15. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në prapësimin e debitorit, duke theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara, sepse këtë e ka ushtruar vetëm sa për të zvarritur procedurën e përmbarrimit, dhe nuk ekzistojnë asnjëra nga shkaqet e prapësimit të parapara në nenin 71.1 dhe 71.12 të LPP-së, sepse sipas nenit 29 par. 1.3 të LPP-së, fatura është dokument i besueshëm.
16. Më 14 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Vendimit [PPP 62/16] aprovon prapësimin e debitorit-KEDS, si dhe e anulon Urdhrin [P.nr. 01/16] e 13 janarit 2016, të Përmbarruesit Privat A.M.
17. Pas ankesës respektive të parashtruesit të kërkesës, më 20 shkurt 2019, Gjykata e Apelit me Vendimin [Ac.nr.2112/17] e aprovon ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe lëndën e kthen në rigjykim. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit ishte se: *“Kjo është procedurë përmbarrimore e zhvilluar sipas ligjit mbi procedurën përmbarrimore, dhe se është në kompetencën e Përmbarruesit Privat dhe Fatura e rregullt paraqet dokument të besueshëm që mund te ekzekutohet në procedurë përmbarrimore.”*

Procedura e dytë

18. Në procedurën e rigjykimit, më 24 maj 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr. 436/19], refuzoi si të pabazuar prapësimin e debitorit KEDS, të ushtruar kundër Urdhrit [P.nr.01/16] për lejimin e përmbarrimit të 13 janarit 2016, i lejuar nga Zyra Përmbarrimore A.M. -përmbarruesi Privat në Prishtinë.
19. Kundër Aktvendimit të lartcekur, në afat ligjor ankesë ushtroi debitori-KEDS, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore si dhe vërtetimit të gabuar të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e tij si të bazuar, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e atakuar dhe të anulohet Urdhri [P.nr.01/16] të 13 janarit 2016, për lejimin e përmbarrimit.
20. Më 2 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4164/19]: (i) aprovoi si të bazuar ankesën e debitorit – KEDS; si dhe (ii) anuloi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP.nr.436/19] të 24 majit 2019, si dhe çështja iu kthye të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Procedura e tretë

21. Më 27 janar 2020, Gjykata Themelore obligoi parashtruesin e kërkesës që të përcaktojë kohën -afatin e përmbushjes së detyrimit në kuptim të nenit 30 të LPP-së. Ndërsa më 3 korrik 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.2079/19] vendos që: (i) Gjykata Themelore shpallet in kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas propozimit të kreditorit –KEK me

numër [PPP.nr.2079/19] kundër debitorit KEDS, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh; (ii) Hedhet poshtë si i palejuar urdhri përmbartimor, i lejuar sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, me numër [P.nr.01/16] i 13 janarit 2016, nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat A.M., kundër debitorit KEDS, lidhur me çështjen kthim i borxhit; (iii) shfuqizohet Urdhri i Përmbartuesit Privat A.M., [P.nr. 01/16] i 13 janarit 2016, mbi caktimin e përmbartimit, për shkak të in kompetencës në këtë çështje përmbartimore.

22. Kundër Aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës brenda afatit ligjor paraqiti ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Urdhri i Përmbartuesit Privat A.M., [nr.P-01/16] i 13 janarit 2016, të mbetet në fuqi.
23. Brenda afatit ligjor, përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori me propozim që të refuzohet si e pathemeltë ankesa e parashtruesit të kërkesës, të vërtetohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore [PPP.nr.2079/19] i 3 korrikut 2019, ashtu që të shfuqizohet Urdhri përmbartimor [P.nr.01/16] i 13 janarit 2016, i Përmbartuesit Privat A.M.
24. Më 13 prill 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3609/2020] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PPP.nr.2079/19] të 3 korrikut 2020. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit theksonte si në vijim:

"Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë ka akceptuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për faktin se nga Marrëveshja për furnizim me shumicë e lidhur në tetor 2012 e lidhur në mes KEIK dhe KEDS, përkatësisht nga neni 28.4 i po kësaj marrëveshje është përcaktuar se: "palët për çdo kontest, dallim apo pretendim që rrjedh apo ndërlidhet me këtë marrëveshje, me shkeljen, shkelputjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL), të cilat janë të zbatueshme për momentin apo në rast se rregulla të caktuara të zbatueshme të arbitrazhit UNCITRAL-it për çështjen në fjalë janë përjashtuar përmes kësaj Marrëveshje në bazë të drejtës procedurale të Zvicrës".

Gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbartimore. Në Nenin 20.1 të LPK-së, i cili përcakton se: "Po që se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin gjykata të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të palës së paditur do të shpallet inkompetente, do t'i aliuoj veprimet e kryera në procedurë dhe do të hedhë poshtë padinë". Po ashtu në nenin 511 të LPK-së është përcaktuar se: "Palët mund të merren vesh që zgjidhjen e kontestit lidhur me të drejtat me të cilat mund të disponojnë

lirisht, t'ia besojnë arbitrazhit". Ndërsa në nenin 514.1 të LPK-së është përcaktuar se: Në qoftë se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar kompetencën e arbitrazhit, gjykata të cilës i është paraqitur padia për zgjidhjen e të njëjtit kontest dhe midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të të paditurit shpallet jokompetente, i anulon veprimet procedurale të kryera dhe me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme. Neni 17 i LPP-së ka përcaktuar se: "Në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat e LPK-së".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së.
26. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjkata e Apelit ka bërë interpretime të gabuara ligjore, me rastin e marrjes së Vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës theksonte se gjykatat e rregullta në disa raste nuk mund të shpallen inkompetente, për shkak se: përkitazi me atë se mbi çfarë bazë juridike caktohet përmbartimi në nenin 21 të LPP-së thuhet "*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm...*". Parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson se cilat janë dokumente të besueshme, në nenin 29 të LPP-së thuhet "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm...*". Dokument i besueshëm, sipas nenit 29.1.3 të LPP-së është edhe fatura.
27. Sa i përket kompetencës së Përmbartuesit privat për nxjerrjen e urdhrit për përmbartim, sipas parashtruesit të kërkesës në rastin konkret përmbartuesi është kompetent dhe kompetenca e tij buron nga neni 323.1 të LPP-së ku thuhet "*Përmbartuesi privat për kryerjen e autorizimeve publike të besuara me këtë ligj emërohet nga Ministri i Drejtësisë për territorin e Gjykatës themelore*", gjersa me nenin 323.2 të LPP-se thuhet se "*Përmbartuesi privat është kompetent të ndërmarrë të gjitha veprimet të përcaktuara në nenin 341 të këtij ligji dhe veprime të tjera të lejuara apo përcaktuara për përmbartuesin privat sipas këtij ligji ...*". Në nenin 341.1 të LPP-së thuhet "*1. Përmbartuesi privat në procedurën e caktimit dhe të zbatimit të përmbartimit, në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e parapara me këtë ligj: 1.1. nxjerr urdhër për përmbartim dhe zbaton përmbartimin në pajtim me autorizimet e tij*".
28. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës lidhur me këtë çështje nuk ka nevojë që në procedurë kontestimore me arbitrazh të sigurohet titull i ri ekzekutiv kur një titull i tillë ekziston dhe ka bazë ligjore që çështja e borxhit sipas faturës të përfundohet në procedurë përmbartimore.
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjkata që (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me

nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [AC 3609/2020] e 13 prillit 2020; (iv) ta kthejë Aktvendimin [AC 3609/2020] e 13 prillit 2020 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese; (v) ta urdhërojë Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

[...]

Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

Neni 17

Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera

Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

Neni 21

Bazat juridike për caktimin e përmbarimit

Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.

Neni 29

Dokumentet e besueshme

1. Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është:

[...]

1.3. faturat;

Neni 323

Statusi dhe kompetencat e përmbartuesit privat

1. Përmbartuesi privat për kryerjen e autorizimeve publike të besuara me këtë ligj emërohet nga Ministri i Drejtësisë (më tutje: Ministri) për territorin e Gjykatës themelore.

2. Përmbartuesi privat është kompetent të ndërmarrë të gjitha veprimet të përcaktuara në nenin 341 të këtij ligji dhe veprime të tjera të lejuara apo përcaktuara për përmbartuesin privat sipas këtij ligji, përveç kur shprehimisht ndalohen me këtë ligj.

Neni 341

Detyrat e përmbartuesit privat

1. Përmbartuesi privat në procedurën e caktimit dhe të zbatimit të përmbartimit, në pajtim me dispozitat dhe kufizimet e parapara me këtë ligj:

1.1. nxjerrë urdhër për përmbartim dhe zbaton përmbartimin në pajtim me autorizimet e tij;

1.2. pranon dhe vepron sipas propozimeve për përmbartim të kërkesave dhe të propozimeve për zbatim të përmbartimit të kërkesave dhe cakton mënyrën e përmbartimit nëse kreditori nuk e ka caktuar në propozim;

1.3. të dorëzojë urdhra, akte, dhe shkresa;

1.4. Të identifikojë palët dhe pjesëmarrësit në procedurën përmbartimore;

1.5. të mbledh të dhëna për gjendjen pasurore të debitorit;

1.6. të nxjerr konkluzione, përpilojë procesverbale, kërkesa dhe të dhëna tjera zyrtare në pajtim me autorizimet e parashikuara me këtë ligj;

1.7. të kryejë regjistrimin, vlerësimin e pronës, sekuestrimin dhe shitjen e pasurisë së luajtshme dhe të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme;

1.8. të pranojë dhe ruajë pasurinë e regjistruar dhe të siguruar të debitorit, urdhërojë transferin e pronësisë dhe kryejë ndarjen e pasurisë dhe mjetet tjera monetare të realizuara me shitjen e pasurisë;

1.9. të kryejë zhvendosjen dhe veprimet tjera përmbartimore për qëllime të përmbartimit në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore;

1.10. sipas kërkesës së debitorit apo kreditorit, përmbartuesi privat ndërmjetëson ndërmjet tyre për qëllime të arritjes së marrëveshjes;

1.11. të pranojë dhe transferoj mjete monetare në pajtim me këtë ligj;

- 1.12. të mbajë evidence të rasteve në të cilat ai vepron në pajtim me formën e përcaktuar nga Ministri;
- 1.13. të ndërmarrë veprime të tjera siç parashikohet me këtë ligj te nxjerra ne zbatim te këtij ligji.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 20

20.1 Po që se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin, gjykata, të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të palës së paditur do të shpallet inkompetente, do t'i anulojë veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë. Gjykata nuk vepron kështu vetëm po që se konstaton se kontrata mbi arbitrazhin nuk është e vlefshme, se ka pushuar vlefshmëria e saj apo se nuk mund të realizohet.

PROCEDURA E GJYKIMEVE TE ARBITRAZHIT

Neni 511

511.1 Palët mund të merren vesh që zgjidhjen e kontestit, lidhur me të drejtat me të cilat mund të disponojnë lirisht, t'ia besojnë arbitrazhit.

511.2 Marrëveshja për arbitrazh mund të bëhet nga palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar apo për zgjidhjen e kontesteve që mund të lindin midis tyre nga raporti materialo-juridik i caktuar. Marrëveshja për arbitrazhin është e vlefshme vetëm po që se është lidhur në formë të shkruar.

511.3 Marrëveshja për arbitrazh konsiderohet e lidhur në formë të shkruar edhe kur është lidhur me këmbimin e letrave, telegrameve, telekseve apo mjeteve tjera të telekomunikacionit që e mundësojnë provën e shkruar mbi marrëveshjen e përfunduar.

511.4 Marrëveshja për arbitrazh konsiderohet e lidhur në formë të shkruar edhe po që se është lidhur duke u këmbyer padia, në të cilën paditësi pretendon se ekziston marrëveshja dhe përgjigja në padi, në të cilën i padituri nuk e mohon një gjë të tillë.

511.5 Marrëveshja për arbitrazh mund të provohet vetëm me anë të shkresave.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

[...]

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

32. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr.

KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

33. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve tjera të përmendura më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin Ac.nr.3609/2020 e 13 prillit 2021, të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu rastin KI175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
36. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
37. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjellë në vëmendje se, në rrethanat e rastit konkret, çështja thelbësore ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me pagimin e faturës nga ana e debitorit-KEDS, si rezultat i

marrëveshjes së shitjes me shumicë të rrymës elektrike, dhe se sipas pretendimit të tij, debitori kishte përmbushur pjesërisht obligimin e tij dhe se i njëjti kishte mbetur pa paguar shumën 4.340.491,00 euro, nga totali i faturës. Duke vepruar sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Përmbartuesi Privat A.M., kishte lëshuar Urdhër me të cilën lejonte përmbartimin në bazë të provës së besueshme-faturës për pagimin e borxhit të lartcekur. Si rezultat i kontestimit të Urdhrit të Përmbartuesit Privat nga ana e debitorit-KEDS dhe si rezultat i një sërë procedurash, Gjykata e Apelit e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, sepse neni 28.4 i Marrëveshjes për furnizim me shumicë të energjisë elektrike e lidhur në mes të parashtruesit dhe KEDS, përcaktonte se palët për çdo kontest, dallim apo pretendim që rrjedh apo ndërlidhet me këtë marrëveshje, me shkeljen, shkeljet apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL). Gjithashtu, Gjykata e Apelit theksoi se përderisa palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin, atëherë gjykata shpallet inkompetente dhe e hedhë poshtë padinë.

38. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe ii) shkeljet e pretenduara të neneve 54 dhe 102 të Kushtetutës.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

39. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit shkelë të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, ku ai kryesisht thekson se Gjykata e Apelit ka bërë interpretime të gabuara ligjore.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih në këtë kontekst rastet e Gjykatës KI128/18, Parashtrues: *Limak Kosovo International Airport J.S.C.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
41. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka

bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura atje; dhe shih gjithashtu rastet KI128/18, të cituara më sipër, paragrafi 56; dhe KI62/19, të cituar më lart, para 58).

42. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykata e Apelit. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
43. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPP. nr. 2079/19] shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës kundër debitorit –KEDS, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh, për arsyet vijuese:

[...] prapësimi i debitorit sa i përket kompetencës së kësaj gjykate është i bazuar, pasi që për vendosjen e kësaj çështje përmbartimore kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore nga arsyet në vijim:

Me Marrëveshjen për Furnizim me Shumicë e lidhur në Tetor 2012 e lidhur me KEK dhe KEDS, me nenin 28 paragraf 4, palët kanë përcaktuar: "palët për çdo kontest, dallim apo pretendim që rrjedh apo ndërlidhet me këtë Marrëveshje, me shkëlqen, shkëputjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL). të cilat janë të zbatueshme për momentin apo në rast se rregulla të caktuara të zbatueshme të arbitrazhit UNCITRAL-it për çështjen në fjalë janë përjashtuar përmes kësaj Marrëveshje në bazë të drejtës procedurale të Zvicrës".

Mbi bazën e të cekurave si më lartë e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore me të cilin është përcaktuar në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore", rezulton se kjo gjykatë është inkompetente për vendosjen lidhur me propozimin e kreditorit, prandaj për këtë arsye e në bazë të neneve 20, 511, 514 dhe nenit 391 par. 1 pika "a" e Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 73 të Ligjit për Procedurën përmbartimore. vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

44. Në fund, në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës vendosi edhe Gjykata e Apelit, e cila e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3609/2020] ku në mënyrë të detajuar arsyetohet si në vijim: “*Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë ka akceptuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për*

faktin se nga Marrëveshja për Furnizim me Shumicë e lidhur në Tetor 2012 e lidhur në mes KEK dhe KEDS, përkatësisht nga neni 28.4 i po kësaj marrëveshje është përcaktuar se: "palët për çdo kontest, dallim apo pretendim që rrjedh apo ndërlihet me këtë marrëveshje, me shkeljen, shkelputjen apo pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhet ekskluzivisht dhe përfundimisht me arbitrazh, në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të [...] (UNCITRAL), të cilat janë të zbatueshme për momentin apo në rast se rregulla të caktuara të zbatueshme të arbitrazhit UNCITRAL-it për çështjen në fjalë janë përjashtuar përmes kësaj Marrëveshje në bazë të drejtës procedurale të Zvicrës".

Gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbarimore. Në nenin 20.1 të LPI-së i cili përcakton se: "Po qe se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin gjykata të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të palës së paditur do të shpallet inkompetente, do t'i anulohet veprimet e kryera në procedurë dhe do të hedhë poshtë padinë". Po ashtu në nenin 511 të LPK-së është përcaktuar se: "Palët mund të merren vesh që zgjidhjen e kontestit lidhur me të drejtat me të cilat mund të disponojnë lirisht, t'ia besojnë arbitrazhit". Ndërsa në nenin 514.1 të LPK-së është përcaktuar se: "Në qoftë se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar kompetencën e arbitrazhit, gjykata të cilës i është paraqitur padia për zgjidhjen e të njëjtit kontest dhe midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të të paditurit shpallet jokompetente, i anulon veprimet procedurale të kryera dhe me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme. Neni 17 i LPP-së ka përcaktuar se: "Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht të zbatohen dispozitat e LPK-së".

45. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtuesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 58).
46. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtuesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, për shkak se gjykatat e rregullta kanë zbatuar ligjin "në dëm të këtij parashtuesi të kërkesës", nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë

“qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës, apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih: në këtë drejtim, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtrues: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41 dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

47. Përfundimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të interpretimit të gabuar dhe aplikimit të gabuar të ligjit të zbatueshëm janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
48. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese dhe shpallet i papranueshëm, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 54 dhe 102 të Kushtetutës

49. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës. Pra, parashtruesi i kërkesës, konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se i njëjti në “*mënyrë arbitrare*” ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me nenet 54 dhe 102 të Kushtetutës. Në vijim, Gjykata do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e këtyre pretendimeve të parashtrueses së kërkesës.
50. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar kur pretendimet janë “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” ose kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
 - a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* i 31 majit 2005, kërkesa nr. 4241/03; shih gjithashtu, *Baillard kundër Francës (vendim)* i 25 shtatorit 2008, kërkesa nr. 6032/04);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht

vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

51. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, "*në mënyrë arbitrare*" ka shkelur të drejtat e tij individuale dhe ka ardhur deri te shkelja e nenit 54 të Kushtetutës, mirëpo i njëjti, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
52. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse ky pretendim cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve "*të pambështetura ose të paarsyetuara*", pasi parashtruesi i kërkesës thjesht ka cituar një dispozitë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, pa shpjeguar se si është shkelur ajo. Prandaj, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
53. Përfundimisht, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të pretenduara të nenit 102 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ky nen nuk hyn në kategorinë e të Drejtave dhe Lirive Themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Rrjedhimisht, pretendimi për shkelje të këtij neni duhet të ndërlihet dhe të argumentohet me ndonjë të drejtë tjetër të përcaktuar në kapitullin II (Shih *mutatis mutandis* rastin e Gjykatës: KI81/19, me parashtrues *Skender Podrimqaku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 dhjetorit 2019, paragrafi 75).
54. Prandaj, edhe lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 102 të Kushtetutës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

55. Në fund, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ka ardhur deri te interpretimi i gabuar dhe aplikimi i gabuar i ligjit të zbatueshëm, janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; dhe si të tilla këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; (ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar, sepse i njëjti cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”; si dhe (iii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 102, është qartazi i pabazuar, pasi që i njëjti nuk hyn në kategorinë e të Drejtave dhe Lirive Themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, si dhe nuk është ndërlidhur dhe argumentuar me ndonjë të drejtë tjetër të përcaktuar në kapitullin II. Prandaj, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka Nimani